

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Media italiane - Rrjeti i spiunazhit rus në Romë: Nga ushtria te politika, ekonomia dhe Vatikani
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917286/rrjeti-i-spiunazhit-rus-ne-rome-nga-ushtria-te-politika-ekonomia-dhe-vatikani/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:55:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:18:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	48d6cc016c7df24c727f00493a7ef3b6cf6790bdc6d52f5f939736baba75dccf
TEKSTI	15aca31d1bdd2cbabc3712bb0732e9db9906163128f013a77bca386977b9b9c6
PAMJA	bcd54811ac3047f007ab4514030bff4fd0a126b4f4e722b59ffecf8d8380bb9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8c059d660cc74f10f1d74758b50f180300cbe1aba9b7735f7fd6a8a2d3d2691a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	554d51ffe1583614fc44621ae1478dd51416957b577076ef62782afd72e64dbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8c059d660cc74f10f1d74758b50f180300cbe1aba9b7735f7fd6a8a2d3d2691a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë

LAJMI I FUNDIT

LIVE - Sot seancë plenare dhe protesta



më të lexuarat

Pakistani dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës

Forcat izraelite tërhiqen nga qyteti perëndimor i Sirisë pas një ofensive disa orëshe

Sulmet me dronë dhe raketa nga Irani/SHBA thirrje amerikanëve: Rishqyrtoni udhëtimet në Arabinë Saudite

Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s'duhet të prishen

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët

Koreja e Veriut zhvillon stërvitje me raketa balistike me reze të gjatë veprimi

Rrjeti i spiunazhit rus në Romë: Nga ushtria te politika, ekonomia dhe Vatikani

11:18, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Alba Kepi

Media italiane "Il Riformista" publikon një hetim të fortë mbi një rrjet të dyshuar të inteligjencës ruse që vepron përmes ambasadës së Rusisë në Romë dhe që, sipas rindërtimit të publikuar, shtrihet përtej fushës ushtarake, duke prekur politikën, ekonominë, kulturën, gazetarinë, aktivizmin dhe marrëdhëniet me Selinë e Shenjtë.

Në qendër të çështjes janë Ivan Petrovich Gorbachev dhe Mikhail Vasilyevich Astakhov, respektivisht atasheu dhe zëvendësatasheu detar i ambasadës ruse në Romë, të cilët lidhen me GRU-në, shërbimin e inteligjencës ushtarake ruse.

Të dy u dëbuan nga Italia më 9 korrik, pas hetimit të Prokurorisë së Romës mbi kalimin e informacioneve të rezervuara drejt Rusisë. Hetimi italian kishte dokumentuar kontaktet e tyre me dy ish-pjesëtarë të inteligjencës italiane, të dyshuar se kishin furnizuar Rusinë me informacion konfidencial.

Nga ushtria te NATO

Në hetim përmenden edhe Igor Alexeyevich Anikeyev dhe Igor Albertovich Ovechkin, këshilltarë të ambasadës ruse, të lidhur me FSB-në, shërbimin e sigurisë së brendshme të Rusisë.

Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, fokusi i tyre lidhet me mbledhjen dhe analizimin e informacioneve mbi strukturat italiane, veçanërisht kapacitetet ushtarake dhe teknologjitë e lidhura me NATO-n.

Kontakte me politikën dhe ekonominë

Rrjeti i përshkruar nuk kufizohet te mbrojtja. Në të shfaqen edhe Anton Andreyevich Demin dhe Dmitry Yuryevich Morozenko, diplomatë që lidhen me SVR-në dhe GRU-në.

Sipas hetimit, ata kishin kontakte me shoqata kulturore ruse, sipërmarrës italianë aktivë në tregun rus dhe persona të tjerë që, për shkak të pozicionit të tyre, mund të përbënin pika akses drejt informacioneve dhe mjediseve të ndryshme.

Megjithatë, një kontakt me një shoqatë kulturore apo me një sipërmarrës nuk përbën në vetvete provë të një aktiviteti spiunazhi. Rëndësi kanë natyra e kontakteve, vazhdimësia e tyre dhe informacionet që kërkoheshin.

Dyshime për sabotazh dhe sulme kibernetike

Një nga elementet më të ndjeshme lidhet me pretendimet për përgatitjen e veprimeve të mundshme në territorin europian.

Sipas hetimit, janë evidentuar përpjekje për rekrutimin e qytetarëve bjellorë dhe të vendeve të tjera të Europës Lindore, të cilët potencialisht mund të përdorshin për sabotazh ndaj infrastrukturave civile ose ushtarake.

Po ashtu përmendet mbledhja sistematike e informacionit mbi dobësitë e infrastrukturave dixhitale. Të dhëna të tilla mund të përdoren për të identifikuar sistemet më të ekspozuara ndaj sulmeve kibernetike.

Italia si pikë tranziti

Hetimi ngre gjithashtu çështjen e lëvizjeve të qytetarëve rusë dhe bjellorusë përmes territorit italian drejt vendeve të tjera europiane.

Sipas rindërtimit, Italia mund të jetë përdorur si pikë tranziti për persona që më pas udhëtonin drejt vendeve të tjera të zonës Schengen.

Në këtë kontekst përmendet edhe rasti i një shtetasi bjellorus me pasaportë ruse, i dyshuar në Gjermani për përfshirje në një tentativë sulmi me dron ndaj aeroportit të Leipzigit. Sipas raportimeve gjermane, ai kishte hyrë në zonën Schengen me një vizë italiane.

Megjithatë, ky rast nuk provon një lidhje mes tij dhe rrjetit të përshkruar dhe as nuk dëshmon se Italia është përdorur prej tij si bazë operative.

Gjurmët që çojnë në Vatikan

Një tjetër emër i përmendur është Konstantin Alexeyevich Nemudrov, atashë pranë ambasadës ruse të akredituar në Selinë e Shenjtë.

Babai i tij, Alexey Nemudrov, ishte dëbuar nga Italia në vitin 2021 në kuadër të çështjes Walter Biot, oficeri i Marinës italiane i dënuar për dorëzimin e dokumenteve të klasifikuara te një funksionar rus.

Një burim i ciftuar në hetim pretendon se një pjesë e rolit të babait mund të jetë vazhduar nga i biri, veçanërisht në lidhje me informacionet mbi marrëdhëniet me Vatikanin dhe mjediset fetare.

Ky pretendim i atribuohet burimit dhe duhet dalluar nga faktet e dokumentuara mbi detyrën diplomatike të Nemudrov.

Një rrjet me shumë drejtime

Rindërtimi i publikuar paraqet një aktivitet rus që shtrihet në disa drejtime: ushtria, teknologjia, NATO, ekonomia, politika, kultura, gazetaria, aktivizmi dhe Vatikani.

Në këtë panoramë përfshihen edhe dyshime për rekrutim, përgatitje sabotazhesh, mbledhje informacioni mbi dobësitë dixhitale dhe monitorim të lëvizjeve të qytetarëve rusë e biellorusë në territorin italian.

Në fund, artikulli ngre pikëpyetje edhe për incidentin e 13 gushtit në impiantin e KNDS Ammo Italy, ish-Simmel Difesa, në Colleferro. Megjithatë, nuk paraqitet ndonjë provë që e lidh drejtpërdrejt këtë incident me rrjetin rus të përkshruar.

Hetimi paraqet kështu një panoramë të një lufte hibride ku spiunazhi, mbledhja e informacionit, ndikimi dhe monitorimi i marrëdhënieve mund të zhvillohen paralelisht me aktivitetin diplomatik zyrtar.

BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë
'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut

Trump kërcënon BE me ndërprerje të tregtisë nëse Kanadaja bëhet anëtare e asociuar

Arabia Saudite lëshon alarme emergjente për 'rrezik potencial' në Xheda, Mekë dhe Taif

Le spie russe che Mosca nasconde nella sua ambasciata a Roma

■ **Massimiliano Coccia**

Arima tutto sembra scorrere in modo sereno e quasi grottesco. E anche la guerra degli apparati russi non ha bisogno di mostrarsi per essere presente: può assumere la forma discreta di un incarico diplomatico, di una relazione coltivata per mesi, di una cena in una vecchia osteria, di un incontro culturale, di un contatto con un imprenditore o di una conversazione apparentemente ordinaria con qualcuno che lavora nella Difesa.



Astakhov Mikhail Vasil'yevich

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.